Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës se prokurimi/kontratës	Vlera e shpallur fituese

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shënim: Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

⁴ Kjo deklarate ka si qëllim plotësimin e kriterit ligjor që operatori ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent

Shtojca 12

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*
- c. *Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;*
- ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- d. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;*
- e. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*
- f. *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*
- g. *Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;*
- gj. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme për kualifikim .

2.2. Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjatë tre viteve të fundit 2017, 2018 dhe 2019, duhet të mos jetë më e vogël se 50% e fondit limit të procedurës së prokurimit. *Per të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit.*

2.2.2 Operatori Ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm gjatë tre viteve të fundit 2017, 2018 dhe 2019. *Per të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve të tre viteve të fundit (si më sipër), të paraqitura pranë autoritetit përkatës, të konfirmuara nga ky autoritet , **ne të cilat duhet të rezultojë se nuk ka dale me humbje të pakten në dy vite të njëpasnjëshme.** si dhe të shoqëruara me akt ekspertizën e kryer nga Eksperti kontabel i autorizuar.*

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga cdo njësi vendore për të dëshmuar se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitet 2019

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e informacionit të paraqitur. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Për Prokurimin Publik”.

2.3 Per kapacitetin teknik:

2.3.1/a Operatori Ekonomik duhet te kete realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 35 % e fondit limit dhe që është realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit;

2.3.1/b. ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit, **është jo më e vogël se dyfishi i fondit limit** dhe që është realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit.

Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

2.3.1/a Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese **formularët e vlerësimit** sipas shtojces perkatese te DST te shoqeruar **me kontraten/kontratat** e nenshkruara nga palet, **situacionet perfundimtare, faturat tatimore, aktet e kolaudimit.** Formulari i vlerësimit duhet te percaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes se punëve, dhe faktin nëse kontrata eshte realizuar me sukses.

2.3.1.b Në rastin e pervojes se ngjashme ne sektorin privat kerkohet si deshmi kerkohet si deshmi **vertetim leshuar nga subjekti privat** shoqeruar **me kontrate** e nenshkruara nga palet, **situacionet perfundimtare, faturat tatimore, akt kolaudimi te objektit.** Vertetimi duhet te percaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes se punëve, dhe faktin nëse kontrata eshte realizuar me sukses.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar, me jo më pak se 180 punonjes, për periudhën (Janar 2020 – Korrik 2020), e vërtetuar kjo me: *Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e kerkuar, shoqeruar me formularët E-SIG te konfirmuara nga organet perkatese (me nenshkrim elektronik ose ne hard copy).*

2.3.3 Operatoret ekonomike duhet te disponojne licensat e nevojshme per zbatimin e kontrates. Per kete duhet te paraqesin licensen perkatese te shoqerise, bazuar ne formatin e miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi". Shqyrtimi i licencave do te behet mbi bazen e rregullave te parashikuara sa me siper. Licensa profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates duhet te permbaje kategorite e meposhtme:

- NP – 1/G (Punime germimi ne toke.)
- NP – 4/G (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.)
- NP – 5/F (Punime nentokesore, ura e vepra arti.)
- NP -9/F (Punime te mbrojtjes lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikimi)
- NP – 12/F (Punime të inxhinierisë së mjedisit.)
- NS – 6/B Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.
- NS – 8/C Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri

- NS – 9/E(Punime strukture speciale)
- NS – 13/A Impiante dhe linja telefonike dhe telekomunikacioni
- NS -18/ D (Punime topogjeodezike)

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktura dhe Energjise, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). **Mosparaqitja në këto forme është kusht skualifikues.**

2.3.4 Operatori Ekonomik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, duhet të vertetojë
a) se ka në licencën e shoqërisë, drejtuesit teknik , minimalisht,

1 (nje) Inxhinier Ndërtimi
1(nje) Inxhinier Hidroteknik
1 (nje) Inxhinier Mekanik
1(nje) Inxhinier Topograf/ Gjeodet
1(nje) Inxhinier Elektrik
1 (nje) Inxhinier mjedisi

Për secilin pjestar të stafit teknik të mesiperm duhet të paraqesë, Kontrate pune e vlefshme, diplome , Libreze pune dhe CV, (Drejtuesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi)

b) Ka në stafin teknik

1 (nje) Inxhinier Ndërtimi/ profili transport;
1(nje) Inxhinier Hidroteknik
2(dy) Inxhinier Topograf/ Gjeodet
1(nje) Inxhinier Hidrogeolog/ Gjeolog
1(nje) Arkitekt

Për secilin pjestar të stafit teknik të mesiperm duhet të paraqesë, Kontrate pune e vlefshme, diplome , Libreze pune dhe CV,

2.3.5 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve (inxhinier ndërtimi) në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme: diplome , libreze pune dhe kontrate pune.

2.3.6. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 25 (njetëzet e pesë) punonjës manovratorë, për të cilët duhet të paraqesë kontrate individuale të punës të vlefshme, Dëshmi Aftësie Profesionale (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse,

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 25 (njetëzet e pesë) punonjës shofere, për të cilët duhet të paraqesë kontrate individuale të punës të vlefshme, patentën përkatëse (për drejtim kamioni),

2.3.8 Operatori Ekonomik duhet te deklaroje me shkrim se inxhinieret dhe punonjesit e kerkuar ne piken 2.3.4 / b, 2.3.5,2.3.6, 2.3.7 per kualifikim jane te paangazhuar ne kontrata te tjera.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (një)punonjës që disponon çertifikatën si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit ne pune”** në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Për specialistin e shoqërisë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit për “Specialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë”e dhëne nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj dhe kontrata e punës e vlefshme, Nese ofertuesi do te paraqitet si bashkim operatorësh, sejcili prej operatorëve duhet të ketë të punësuar 1 (një)punonjës që disponon çertifikatën si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit ne pune”**

2.3.10 Operatori Ekonomik duhet te kete ne perberje te stafit te perhershëm 1 punonjes te çertifikuar **“Ekspert per ndihmen e pare dhe nderhyrjen ndaj emergjencave”**e cila te jete e leshuar nga shoqeri te akredituara ose nga organizma nderkombetare akreditues te njohur nga republika e Shqiperise.

2.3.11 Operatori Ekonomik duhet te kete ne përbërje te stafit punonjësit ne përputhje te plote me VKM nr. 632, date 15.07.2015, i ndryshuar.

Operatori Ekonomik **duhet te kete ne perberje te stafit Nje Mjek** ne perputhje te plote me VKM nr.108 date 09.02.2011, i ndryshuar, te vertetuar me kontrate pune te vlefshme, diplome CV, leje ushtrimi profesioni te leshuar nga Urdheri i Mjekut.

2.3.12 Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates. *Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik.*

Kerkohen te jene ne dispozicion keto mjete pune:

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 30 ton	në pronësi ose me qira	Copë 12
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 20-30 ton	në pronësi ose me qira	Copë 21
3	Kamioncine deri ne 3.5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 6
4	Fadrome me Goma	në pronësi ose me qira	Copë 4
5	Eskavator me goma	në pronësi ose me qira	Copë 3
6	Eskavator me zinxhire (me peshe mbi 20ton)	në pronësi ose me qira	Copë 8
7	Minieskavator nga 5 deri 8 ton	në pronësi ose me qira	Cope 3
8	Çekiç për Eskavator	në pronësi ose me qira	Cope 2
9	Çekiç hidraulik me peshe mbi 150 kg	në pronësi ose me qira	Cope 4
10	Greider	në pronësi ose me qira	Copë 2
11	Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë 2
12	Autopompe betoni	në pronësi ose me qira	Copë 2

13	Autobetoniere(me kapacitet nga 8-12 m3)	në pronësi ose me qira	Copë 10
14	Kamion me vinc	në pronësi ose me qira	Copë 2
15	Autobitumatrice	në pronësi ose me qira	Cope 1
16	Rimorkiator per transport mjetesh mbi 30 ton	në pronësi ose me qira	Copë 3
17	Impiant Betoni e paisur leje mjedisore kodi III.1.B.	në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi	Cope 1
18	Impiant asfalti e paisur leje mjedisore kodi III.1.B.	në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi	Cope 1
19	Impiante per thyerje dhe seleksionim materiale inertesh , jo me larg se 40 km nga objekti e paisur leje mjedisore kodi III.1.B	në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi	Cope 1
20	Buldozier	në pronësi ose me qira	Copë 3
21	Asfaltoshtruese	në pronësi ose me qira	Copë 2
22	Rul gome hekur 20 ton	në pronësi ose me qira	Cope 1
23	Rrul gome hekur 15- 19 ton	në pronësi ose me qira	Copë 5
24	Rrul gome gome me peshe operative 12 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
25	Rrul hekur hekur 10-12 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
26	Gjenerator	në pronësi ose me qira	Copë 3
27	Sonde horizontale shpimi	në pronësi ose me qira	Copë 2
28	Kallep metalike	në pronësi ose me qira	400 m2
29	Matrapik	në pronësi ose me qira	Copë 2
30	Vibrator	Ne pronesi apo me qira	Cope 8
31	Minifadrome	në pronësi ose me qira	Copë 1
32	Deflektometer ose pjaster dinamike per matjme e ngjeshjes se shtresave rrugore	në pronësi ose me qira	Cope 2
33	Makineri vijezi me boje bikomponente	në pronësi ose me qira	Copë 1
34	Pajisje per hekurkthyes (tranxhe/bango)	në pronësi ose me qira	Copë 3
35	Motosaldatrice	në pronësi ose me qira	Copë 2

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit: - certifikatën e pronësisë; - leja e qarkullimit; - certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; leja e transportit që leshohet nga njesia vendore dhe fotot perkatese; Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet të përshijë objektin perkates dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore perkatese, fotot, ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet të përshijë objektin perkates dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Për impiantin e asfaltit dhe të betonit, njëen e inerteve duhet të paraqiten kontrata e blerjes apo zhdoganimit, fotot ose fatura tatimore perkatese, leja mjedisore leshuar nga QKL. Nëse është marrë me qira/furnizim krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase/furnizimit. Operatori ekonomik për fabrikën e asfaltit dhe të betonit, njëen e inerteve dhe mund të paraqesë edhe kontrata të vlefshme furnizimi me operatore ekonomike. Në këtë rast duhet

te paraqese kontraten e furnizimit dhe dokumentacionin qe verteton ekzistencen dhe pronesine e impiantit.

- Per impiantin e prodhimit te Inerteve, Impianti i prodhimit te Betonit dhe Impianti i prodhimit te asfaltit operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese raport testimet per materialet si me poshte:

- Raport Testim te Materialeve Inerte, Metoda e Testimit S SH EN 933- 1: 2012.
- Raport Testimi nga Impianti i Prodhimit betonit metoda e e testimit S SH EN 12390 – 3: 2009,
- Raport testimi nga impianti prodhimit te asfaltit metoda e testimit S SH EN 12697 -1 : 2012
- Raport testimi nga impianti prodhimit te asfaltit metoda e testimit S SH EN 12697 -2 : 2015
- Raport testimi nga impianti prodhimit te asfaltit metoda e testimit S SH EN 12697 -34 : 2012 Prova Marshall
- Testimet e mesiperme duhet te jene nga Laborator i akredituar konform S SH ISO/EN 17025:2006.

Raport i testeve duhet te jete sipas standarteve ne fuqi bazuar ne ligjin Nr.9290 date 07/10/2004 “Per Produktet e Nderimit”, i ndryshuar.

- Per mjetet qe transportojne mallra te rrezikshem duhet te paraqitet certifikata perkatese e leshuar nga institucioni kompetent.
- Te gjitha mjetet dhe pajisjet e kerkuara te jene te shoqeruara me foto.
- Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë gjate fazes vleresimit te ofertes e deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr.10.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku Autoriteti Kontraktor rezervon • të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve, me apo pa lajmërim paraprak, si dhe te beje deklarimin e adreses se sakte te vendodhjes se mjeteve me qellim verifikimin e tyre”
Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojte vertetesine e deklarates. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Per Prokurimin Publik”.

2.3.13 Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara ne procedura te shpallura fitues. (Të paraqitet Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese, ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qira me qëllim verifikimin).

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojte vertetesine e deklarates. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Per Prokurimin Publik”.

2.3.14 Operatori Ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese çertifikatat te vlefshme si me poshte:

- ISO 9001 – 2015 (Menaxhimi i cilesise)
- ISO 14001 - 2015 (Menaxhimi i mjedisit)
- BS-OHSAS 18001:2007 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë), ose çertifikaten ekuivalente te njohur nga standartet shqiptare ISO 45001-2018
- ISO 39001:2012 (Sistem i menaxhimit te sigurisë rrugore dhe trafikut)

***Te gjitha certifikata e mesiperme duhet te jene te lëshuara** nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar *per keto standarte nga organizmi kombetar i akreditimit (DPA) ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikatat ISO duhet te jene te perditeluar/ te vlefshme dhe aktive . Nese çertifikatat jane ne gjuhe te huaj duhet te shoqerohen me perkthim ne gjuhen shqipe dhe te noterizuara.*

Nese ofertuesi do te paraqitet si bashkim operatoresh, certifikatat duhet te jene ne perputhje me punimet e marra persiper.

2.3.15 Operatori ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese leje dhe licensa si me poshte:

- License për grumbullimin dhe transportimin, e mbetjeve urbane qe kane ndikim ne mjedis, Kodi III.2.B të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit.
- Licence III.2.A (1+2) - Veprimtarite e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis

2.3.16. Operoret e huaj ekonomikë, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe (si gjuhë e ofertës), të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë te certifikuara “Apostille”. Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 5 tetor 1961, “Për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja”, duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës.

2.3.17. Nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomik, *duhet t`i përmbahen nenit 74, te VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. i ndryshuar.* duhet te dorezohet marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht dhe Prokura e posaçme. Çdo anëtar i grupit, duhet të dorëzojë dokumentat e kerkuara, ne perpjestim dhe perputhje me punet e marrra perisiper sipas marrevshjes se bashkepunimit.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 13

(Shtojcë për t’u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektivit etj: Bashkelidhur

Specifikimet Teknike të Materialeve: Bashkelidhur

Grafiku i Punimeve: Bashkelidhur

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 14

(Shtojcë për t’u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Bashkelidhur DST-ve.

Shtojca 15

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁵

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

⁵ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 16

[Shtojcë për t’u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data_____]

Për: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]*

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme ☐

Njoftojme se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 17

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme ☐ çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 1. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 2. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 1. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/ Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 18

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët – Procedura e Hapur

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërise parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.

- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontratës. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndërtimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jetë dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndërtimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të perkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikë e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupsionit. Veprimet e korrupsionit përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkonsulentit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkonsulentin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkonsulentin një dispozitë që premtim ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t’i përdori për qëllime që s’kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t’i japë

Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikun e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me perjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.

- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë te Autoriteti Kontraktor.
- 13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë egzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve

- 14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t’i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

Neni 15: Ngritja e Kantierit

- 15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.
- 15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor

- 16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.
- 16.2 Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike të rrezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

Neni 17: Zbulimet

